



RËPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 10 nëntor 2016  
Nr. ref.:RK1001/16

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI74/16**

Parashtrues

**X**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
Pml. nr. 3/2016, të 25 janarit 2016**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Artta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga i mituri X (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Mahmut Halimi, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 3/2016, të 25 janarit 2016 lidhur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PAM. nr. 39/2015, të 6 tetorit 2015 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PM. nr. 4/15, të 23 korrikut 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me pretendimin se janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 5.1 (d) [E drejta për liri dhe siguri] dhe nenin 2 të Protokollit nr. 7 [E drejta e apelit në çështjet penale] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka kërkuar moszbulimin e identitetit të tij për shkak të miturisë së tij.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 12 maj 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova, Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 23 qershor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 16 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Nga dokumentet e përmbajtura në kërkesë, rezulton se parashtruesi i kërkesës në bashkëpunim me disa persona tjerë kishte hyrë në mënyrë të kundërligjshme në shtëpinë e një personi të tretë për t'ia marrë paratë dhe të mirat tjera materiale, me ç'rast personi i tretë kishte vdekur nga lëndimet e rënda trupore.

11. Më 2 prill 2015, Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për të mitur kishte paraqitur propozim për ndëshkimin e parashtruesit për shkak të kryerjes së veprave penale vrasje e rëndë nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 1. 4 dhe 1. 6 lidhur me nenin 31 dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK).
12. Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për të mitur kishte ricilësuar veprën penale nga vepra penale vrasje e rëndë në veprën penale grabitje, të paraparë nga neni 329, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1, të nenit 31 të KPK-së.
13. Ndërmjet 10 prillit 2015 deri më 23 korrik 2015, Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për të mitur mbajti disa seanca të shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit, të parashtruesit dhe mbrojtësit të tij dhe i shqiptoi (Aktvendimi PM. nr. 4/15), parashtruesit të kërkesës masën edukuese.
14. Gjykata Themelore në Mitrovicë kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës ishte fajtor sepse kishte kryer veprën penale, të grabitjes nga neni 329, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1, të nenit 31 të KPK-së, si dhe për veprën penale, mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 1 i KPK-së.
15. Më 17 gusht 2015, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës u ankua për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit për shqiptimin e masës edukuese. Parashtruesi po ashtu shprehimisht kërkoi që të thirret në seancën e Kolegjit të Gjykatës së Apelit, me qëllim që pretendimet ankimore t'i paraqet gojarisht.
16. Më 6 tetor 2015, Gjykata e Apelit me Aktvendimin, PAM. nr. 39/2015, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.
17. Pjesa relevante e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, përcakton:

*“Gjykata me rastin e shqiptimit të masës edukative dërgimi në Institucion Edukativo Korrektues është bazuar në të gjitha rrethanat që gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me dispozitën e nenit 28 të KDM, pasi që të miturit kanë kryer veprën penale të dënueshme me burgim prej më shumë se 3 (tre) vite, kanë nevojë për edukim të specializuar dhe masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturve, duke marrë parasysh peshën dhe natyrën e veprës penale. Gjykata me rastin e shqiptimit të masës edukuese si rrethana lehtësuese ka marrë interesin më të mirë për të miturit, moshën e tyre, ku në këtë moshë zhvillimi psikologjik dhe social i fëmijëve janë të bujshme, biografinë dhe kushtet e rënda ekonomike, sjelljet e tyre korrekte në seancat e shqyrtimit gjyqësor, ka qenë hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin për veprat penale të dënueshme mbi 5 vite, të njëjtit e kanë pranuar fajësinë ... ndërsa si rrethana rënduese për të*



miturit konform nenit 74 par. 1 dhe 2 pika 2.2, 2.3 dhe 2.7 të KPRK-së, gjeti shkallën e lartë të dashjes, prezencën e dhunës së vrazhdë, pasoja e vdekjes, mosha e të ndjerit, mënyra e të jetuarit në vetmi, shfrytëzimi i gjendjes së fjetur dhe natën vonë.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante për shqiptimin masës edukative dërgimi në Institucion Edukativo Korrektues, e pranon edhe kjo Gjykatë, dhe konstaton se masën edukative të cilën e ka shqiptuar Gjykata e shkallës së parë, është e drejtë dhe e ligjshme, dhe vlerëson se kjo masë do të kontribuojë në rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri për t'i siguruar edukimin dhe aftësimin profesional, duke zhvilluar përgjegjësitë e tyre personale, me qëllim të parandalimit të sjelljeve recidiviste dhe kjo masë do të kontribuonte në interesin më të mirë të miturve, dhe me këtë do të arrihet edhe qëllimi i masave edukative i paraparë në nenin 19 të KDM".

18. Më 30 nëntor 2015, parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit. Parashtruesi u ankua për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të Ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës po ashtu u ankua për shkelje të nenit 390, paragrafi 1 i KPRK-së, për shkak se seanca e Kolegjit për të mitur në Gjykatën e Apelit është mbajtur pa praninë e tij edhe pse kjo është detyrim ligjor, dhe për më tepër, ai kishte kërkuar nga Gjykata e Apelit që të njoftohet për seancën e Kolegjit.
19. Më 25 janar 2016, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 3/2016), refuzoi të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga parashtruesi dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës së Apelit.
20. Përkitazi me detyrimin ligjor për informim të parashtruesit, pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përcakton:

*"Konform dispozitës së nenit 390. par. 1 . të KPPK kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e Kolegjit të Apelit i dërgohet prokurorit kompetent të Shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Kjo dispozitë aplikohet edhe në procedurën penale ndaj ekzekutorit të mitur që mbështetet në dispozitën e nenit 5 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), sipas së cilit, dispozitat e Kodit penal të Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e sanksioneve Penale dhe çdo ligji tjetër relevant, do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është rregulluar ndryshe. Në Kodin e Drejtësisë për të Mitur kjo çështje nuk rregullohet ndryshe, gjegjësisht nuk ka asnjë dispozitë që dallon nga dispozitat për madhorët përkitazi me informimin e palëve për seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë. Duke u bazuar në këto dispozita, rrjedh konkludimi se të miturit nuk i është shqiptuar dënimi me burgim dhe se nuk ka ekzistuar obligimi i Gjykatës së Apelit që të miturin dhe mbrojtësin e tij t'i informojë për seancën ankimore".*

## **Dispozitat relevante ligjore**

### **KODI I PROCEDURËS PENALE Nr. 04/L-123**

#### **Neni 390 paragrafi 1**

#### **Seanca para Kolegjit të Apelit**

*“1. Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e Kolegjit të Apelit i dërgohet prokurorit kompetent të shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij”.*

### **KODI I DREJTËSISË PËR TË MITUR Nr. 03/L-193**

#### **Neni 5**

*“Dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe të çdo ligji tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është rregulluar ndryshe”.*

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë cenuar të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta për mjete juridike, për shkak të: *“interpretimit të gabuar të dispozitave të nenit 390/1 KPPK lidhur me nenin 5 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur pasi nuk i jepet status i barabartë të burgosurit të miturit i cili ndodhet në masën edukative institucionale, gjegjësisht i është shqiptuar masa dërgimi në institucionin korrektues në kohëzgjatje prej 5 vitesh”.*
22. Parashtruesi po ashtu pretendon shkeljen e të drejtës së tij për liri dhe siguri dhe të drejtës së apelit në çështjet penale.
23. Parashtruesi i drejtohet dhe kërkon nga Gjykata që: (i) Kërkesën e dorëzuar ta pranojë dhe ta deklarojë të pranueshme, (ii) të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të garantuara me dispozitat e cituara në kërkesë bazuar në Kushtetutë dhe Konventë, (iii) të deklarojë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të sfiduar në këtë kërkesë dhe (iv) të urdhërojë Gjykatën e Apelit që të caktojë seancën e Kolegjit në të cilën do të ftojë parashtruesin e kërkesës dhe mbrojtësin e tij dhe, pas mbajtjes së seancës të merr vendim të ligjshëm.

## **Pranueshmëria e kërkesës**

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:



*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

26. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

27. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, që specifikon:

*“Rregulli 36  
Kriteret e pranueshmërisë*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*(...)*

*d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

28. Gjykata po ashtu i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, që përcakton:

*“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

29. Gjykata vëren se në thelb parashtruesi ankohet se për shkak të interpretimit të gabuar nga Gjykata e Apelit të nenit 390 (1) të KPPK-së, lidhur me nenin 5 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, atij i është cenuar e drejta për të qenë i ftuar dhe i pranishëm në seancën e Kolegjit, siç garantohet me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të theksojë se e drejta për “seancë publike” siç garantohet me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës, domosdo nënkupton të drejtën për “seancë gojore”. (Shih, për shembull, rastin *Dory kundër Suedisë*, aplikacioni nr. 28394/95, GJEDNJ, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 37).

31. Parimi i mbajtjes së seancës gojore dhe publike në kontekst penal ka rëndësi të posaçme, me ç’rast, personit të akuzuar me kryerjen e veprës penale në përgjithësi, duhet t’i ofrohet mundësia që të jetë i pranishëm në seancën e gjykatës së shkallës së parë që i plotëson të gjitha kriteret e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës, dhe ku parashtruesi gëzon të drejtën që rasti i tij të “dëgjohet”, me mundësi, ndër të tjera, që të ofroj dëshmi për mbrojtjen e tij, t’i dëgjojë dëshmitë kundër tij, t’i pyes dëshmitarët në favor të tij në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës. (Shih rastin *Jussila kundër*

Finlandës, aplikacioni nr. 73053/01, [DHM], Aktgjykim i 23 nëntorit 2006, paragrafi 40).

32. Megjithatë, prania personale e të akuzuarit nuk ka rëndësi kritike në seancën e apelit sikurse në seancën e gjyimit. Mënyra se si neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës zbatohen në procedurë në gjykatat e apelit, varet nga tiparet e veçanta të procedurës në zhvillim dhe, se duhet të merren parasysh procedurat si tërësi, në rendin juridik dhe roli i Gjykatës së Apelit në atë rend juridik. (Shih rastin *Hermi kundër Italisë*, aplikacioni nr. 18114/02, [DHM], Aktgjykim i 18 tetorit 2006, paragrafi 60).
33. Edhe në rastet ku Gjykata e Apelit ka juridiksion që ta shqyrtojë rastin si në pikëpamje të fakteve, ashtu edhe të ligjit, neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës nuk përcaktojnë që gjithmonë të ushtrohet e drejta për seancë publike, pavarësisht nga natyra e rastit që vendoset. Kriteri për mbajtje të seancës publike, sigurisht se është një nga mjetet me çka mbështetet besimi në gjyqësor. Megjithatë, ekzistojnë faktorë dhe konsiderata tjera, përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm dhe nevojën për administrim efikas të ngarkesës lëndore, që, gjithashtu, duhet të merret parasysh për të vlerësuar nevojën për mbajtje të seancës publike në fazat procedurale pas mbajtjes së gjyimit në shkallë të parë. (Shih rastin, *Fejde kundër Suedisë*, aplikacioni nr. 12631/87, [DHM], Aktgjykim i 29 tetorit 1991, paragrafi 31).
34. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë ka përmbushur kriterin për mbajtjen e seancës publike dhe gojore, sepse seancat e shqyrtimit gjyqësor ishin zhvilluar në praninë personale të parashtruesit dhe mbrojtësit të tij dhe të palës akuzuese në pajtim me parimin e kontradiktoritetit të mishëruar në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka arsyetuar në mënyrë të detajuar duke u bazuar, ndër të tjera, në një mori provash siç janë dëshmitë e dëshmitarëve, raporti i policisë, raporti i mjekëve ligjor, analizat e ADN-së dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes.
35. Bazuar në rrethanat dhe gjendjen faktike të këtij rasti, Gjykata konsideron se parashtruesit i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ishte në gjendje që gjatë fazave të ndryshme të procedurës, të nxjerrë argumente dhe dëshmi që ai i konsideroi relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtarë; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar nga gjykatat e rregullta; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimit të goditur ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat shikuar në tërësinë e tyre ishin të drejta. (Shih, për shembull, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], aplikacioni nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
36. Për sa i përket pretendimeve të dispozitave tjera të Kushtetutës dhe të Konventës, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës vetëm numëron dhe në përgjithësi përshkruan përmbajtjen e atyre dispozitave pa dëshmuar



saktësisht, se si janë shkelur ato dispozita në rastin e tij, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.

37. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
38. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
39. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe, se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
40. Gjykata thekson se detyrë e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
41. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë të ngre kërkesë të argumentueshme për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (Shih rastin nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).
42. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai, në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
43. Rrjedhimisht, kërkesa, është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

#### **Kërkesa e parashtruesit për moszbulim të identitetit**

44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 8 dhe 40 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, që përcakton:



*“Neni 8*

*Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.*

*Neni 40*

*1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.*

*2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë kujdesen në veçanti që:*

*(...)*

*(vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës”.*

45. Gjykata vëren se parashtruesi është i moshës së mitur prandaj konsideron se ai gëzon mbrojtjen kushtetuese të garantuar me Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës, që, në pajtim me nenin 22 (7) të Kushtetutës, “zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”.
46. Prandaj, Gjykata lejon kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit dhe për respektimin e plotë të jetës së tij private në të gjitha procedurat gjyqësore siç është përcaktuar me nenin 22 (7) të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 8 dhe 40 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2016, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA MIRATOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Altay Suroy



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi